



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 616 Regj

Lushnje, më 09.11.2021

VENDIM SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit të titullit ekzekutiv të debitorit)

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës Përmbaremore Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbaremore nr. 616, datë 22.10.2021, bazuar në Urdhërin e ekzekutimit nr.401, datë 18.10.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

KONSTATOVA:

Se në datë 22.10.2021 është depozituar pranë Zyrës Përmbaremore Lushnje kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me Urdhërin e ekzekutimit nr. 401, datë 18.10.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, me palë:

- Kreditor: Prokuroria Lushnje
- Debitor: Alvaro Ardian Saraçi
- Objekti: Shpenzime proceduriale

Nga ana e Zyrës Përmbaremore Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor*”, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Alvaro Ardian Saraçi nuk ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për ekzekutimin e Urdhërit të ekzekutimit nr. 401, datë 18.10.2021.

Sa më sipër në mbështetje të neneve 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbimor Gjyqësor”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 09.11.2021 – 29.11.2021 të debitorit Alvaro Ardian Saraçi;
2. Ky vendim përpilohet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës Përmbarimore Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Alvaro Ardian Saraçi me banim në Rr. “Reshat Shazivari”, Nd. 44, H. 1, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Alvaro Ardian Saraçi me banim në Rr. “Reshat Shazivari”, Nd. 44, H. 1, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës Përmbarimore Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe të marr kontakte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Procedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 09.11.2021

KRYETARI I ZYRËS
Endrin Kashari

